



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.52, datë 25.09.2024

PËR
MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“KAPANON INDUSTRIAL “ALBACO SHOES” PËR AKTIVITET PRODHIMI 1 DHE 2
KAT”, ME VENDNDODHJE NË AUTOSTRADËN TIRANË-DURRËS,
KM 5, KASHAR, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Albaco Shoes” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Kapanon industrial “Albaco Shoes” për aktivitet prodhimi 1 dhe 2 kat”, me vendndodhje në Autostradën Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Albaco Shoes” sh.a, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.20, datë 06.11.2018.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR

I TERRITORIT

EDI RAMA

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 31/10/2024